



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunes)

Nr./Br./No 01/229 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 68

Data/Datum/Date 25/07/2024

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 25.6.2024, me fillim në orën 10:20. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, Arbër Zenuni. Në fillim, kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 26.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuari kryetar i Komunës, Smajl Latifi, nënkyetar Fatmir Iska, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtore të drejtive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit! Për këtë mbledhje të gjashtë të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
  2. Pjetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
  3. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujo (janar – qershor 2024) të kryetarit të Komunës;
  4. Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKSB-së, për gjashtë (6) - mujorin e parë të vitit 2024;
  5. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2025-2027;
  6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, P- 02302-0, P-02299-0, ZK – Rahovec;
  7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01, Nr. 2918, i datës 26.10.2018, për dhënien e pëlgimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe;
  8. Shqyrtimi i Informatës rreth gjendjes së mbeturinave në Komunën e Rahovecit;
  9. Shqyrtimi i Informatës rreth organizimi të Festivalit të Vjeljes së Rrushit – Hardh Fest 2024;
- Shtesë:** Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit;

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë, para vetes kemi edhe një pikë shtesë që ka të bëjë me vendimin për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit:

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, nënkyetar, kolegë drejtore, anëtarë të Kuvendit. Para jush keni vendimin për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit, kjo pikë ka qenë në seancën e shkurtit. Është kthyer nga ministria, për arsy që kemi pasur një keqkuptim për një pëlgim të Agjencionit Kadastral. Këtë pëlgim tanë e kemi siguruar dhe kërkohet votë për të njëjtën pikë.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë, monitorues, të gjithë prezent! Drejtore, kjo listë a është miratuar një herë në Kuvend? Nëse po, a duhet ta shfuqizojmë vendimin paraprak, apo të shkojmë me vendim të ri? Ose së paku ta kemi një paragraf, ku ky vendim shfuqizon një vendim paraprak.

**Albnor Mullabazi:** Po, Burim, në seancë të shkurtit e kemi kaluar! Nga ministria është kthyer që nuk ka qenë në përputhje me ligjshmëri. Në mars e kemi shfuqizuar dhe tani është si pikë e re.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Atëherë, pikën shtesë e vendosim në votim, kush është “për”... Konstatoj që unanimisht (19), votohet kjo pikë shtesë. Të nderuar anëtarë, tani e vendosim rendin e ditës në votim. Kush është “për”... Konstatoj që me 19 vota pro votohet rendi i ditës.

**Defrim Kafexhiu:** Nuk pata ndonjë propozim për rendin e ditës, por vetëm diskutim. Kryesuesi, paraprakisht, është dashur ta vendosë në diskutim çështjen e rendit të ditës. I nderuari kryetar, nënkyetar, kryesues, kolegë të kuvendit, drejtorë, të gjithë që jeni prezent! Në këtë seancë kërkoj mirëkuptimin e kryetarit dhe të kryesuesit, duke marrë parasysh që në seancën e kaluar është cenuar diskutimi, ju keni kërkuar mirëkuptim nga ne dhe tani unë kërkoj mirëkuptim nga ju që, sot, anëtarët e kuvendit, ta kenë hapësirën e diskutimit më të madhe sesa zakonisht. Të paktën dyfishi i hapësirës së diskutimit që na lejohet me rregulllore. Në seancën e kaluar, për ta përmbyllur seancën më herët, keni kërkuar mirëkuptim për çështje partiake. Kryetari e ka pasur mundësinë të shkojë edhe vetë, por ai ka kërkuar mirëkuptim që ta mbyllim seancën që ju të shkonit ta organizoni 24-vjetorin e themelimit të Aleancës.

**Kryetari:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, nënkyetar, drejtorë të drejtive, anëtarë të Kuvendit, mbikëqyrës të seancës. T’ju them të drejtën, kam vërejtje serioze në mosprezencën e “KosovaPressit” dhe prita që Defrimi do ta trajtojë këtë pikë. Ata kanë kontratë me Komunën e Rahovecit. Arsyetimi që kemi harruar nuk vlen dhe ju siguroj që do ta marrin një vërejtje serioze përmes Zyrës së Prokurimit. Fatkeqësia është që askush prej medieve tonë nuk konkuron, me gjasë, “KosovaPressi” i ka të gjitha komunat. Është hera e dytë që nuk sillet konform kontratës ndaj Kuvendit të Komunës. Atë ditë, në Seancë, nuk ka pasur të bëjë asgjë me parti. Ju siguroj dhe ju betohem! Unë një herë jam betuar në flamur dhe ju betohem që nuk ka pasur asgjë me parti. Organizimi i partisë ka qenë në orën 19:00 dhe gjithçka ka qenë e organizuar paraprakisht. Ka të bëjë vetëm me arsyetimin që e kam dhënë atë ditë, nëse nuk besoni, Sefën e kam dëshmitar. Sefa na ka shoqëruar atje në themelin e Muzeut të Bacës Avdi. Do të jem këtu që bashkë me ekipin tim do t’ju jap përgjigje, për të gjitha shqetësimet të cilat i keni vlerësuar që janë të rëndësishme të paraqiten në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës. I mirëpres ballafaqimet. Rendi i ditës është votuar, e lus kryesuesin të vazhdojë me pikat e rendit të ditës.

## 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

**Kryesuesi:** A kemi diçka lidhur me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”... Me 22 vota pro, votohet pika e parë e rendit të ditës.

## 2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

**Kryesuesi:** Fillimisht, kërkoj nga ju që ta respektoni minutazhin tuaj, në mënyrë që secili ta ketë hapësirën dhe kohën.

**Ilir Pallqa:** Faleminderit! I nderuari kryesues, kryetar, nënkyetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtive, të pranishëm në sallë! Në mes të njerezve ka habi, se si nuk e dërgojnë në përbartues komunën kompanitë që e kanë fituar tenderin. Nuk e dërgojnë sepse ka hajni, janë peng i ekzekutivit dhe ekzekutivi është në dijeni për hajninë. Te kanali i lumit për Fortessë, hajnia është e vizatuar. Nuk ka pasur reagime nga ju, andaj e shtrova në kuvend këtë çështje, sepse e shoh të nevojshme ta shoh reagimin tuaj. Gjithashtu, ka habi se pse nuk ka punime kohë pas kohe. Punime nuk ka, sepse Komuna është në borxhe dhe në këtë rast, Komuna është peng i kompanisë, me pak fjalë, peng të njëri-tjetrit. Drejtorin në QKMF, kryetari e lavdëron. Normale është që e lavdëroni, sepse ai, bashkë me babain e tij, rrinë gatitur në çdo tubim të Aleancës. Gjithsesi, prej stafit ka shumë ankesa për të, për veprime e vendime anuese. I pandehuri - drejtori Avni Morina, a ka mundësi të na tregoni se ku ka mbetur lënda juaj në gjykatë? Mos të harrojmë që je person i përgjithshëm publik dhe është në interes të të gjithëve të dinë rreth çështjes tuaj. Banorët janë të merakosur për ty. A e dini se cili është diskutimi që bëhet më së shumti prej të rinjve që i kanë përfunduar studimet? -“Pse bre duhet ta shpërndajmë kryetarin për të hyrë në punë”? dhe -“Nuk kam qejf të shkoj në tubime!” Kush i shkon për qejfi kryetarit, ai sot mban pozitë nëpër institucione dhe kjo nuk është e mirë. Kryetar, ai që të do ta kujton të keqen, që mos ta përsëritësh.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Ilirin e kam pasur koleg. Kryetar, ty kush të do, të do. Prej 2017-ës kam qenë në këtë kuvend, në listë të Vetëvendosjes, para Ilirit dhe para ish-kolegëve të mi. Çka kam përfituar unë? Profesoreshë kam qenë, nuk e di pse Iliri e thotë këtë gjë. Rast konkret e kanë Shqipen, prej 2010 që ka qenë në Vetëvendosje. Te e mira të gjithë kanë qejf të shkojnë. Ju bëj apel të gjithëve, nëse dëshironi ta shihni punën për së afërm, le të vijnë të gjithë në Aleancë.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Kryetar, i kam disa pyetje: E para, te pjesa e subvencionimit në inpute, te çështja e plehut artificial, qytetarët janë të obliguar të paguajnë 20% participim. A është në rregull t'i obligoni qytetarët me atë 20% dhe të blejnë te e njëjtë kompani? A e vlerësoni që është duke iu bërë diskriminim barnatoreve të tjera bujqësore ose furnitorëve të tjerë me pleh artificial dhe inpute? Konsideroj që, nëse komuna planifikon të subvencionojë një sasi të caktuar, të cilidho prej inputeve ose preparateve të tjera, mund ta japë një kosto të caktuar dhe të thoni që, hipotetikisht, në një ha specia, mund t'ju subvencionojmë dhjetë thasë pleh artificial dhe jo t'u thoni që ne dhjetë t'i financojmë dhe dy të tjerë i merr patjetër aty. Kjo direkt i dëmtton shitësit e tjerë të produkteve të njëjta. Unë e kupto që furnitori mund të jetë i Prishtinës, i Vushtrisë apo i Fushë-Kosovës, sepse është garë e hapur me procedura tenderuese, mirëpo, pjesën e participimit - ju lutem hiqeni participimin. Nuk është e logjikshme, nuk është në rregull. Ndoshta ka ndodhur te pjesa e shpërndarjes së mjeteve bujqësore diçka që është e kontraktuar. Por, te inputet nuk ka logjikë, sepse favorizohet një person ose një biznes. E dyta, te qentë endacakë. Për trajtimin e qenve endacakë është një kontratë, nëse nuk jam gabim, 100.000€. Drejtor, nuk keni mundësi të merni informatë nga kontraktori se çka është duke ndodhur, sepse qenë endacakë kemi kah po lëvizim. Është shqetësuese! Në Xërxë ka shumë, me vathë dhe pa vathë ose të trajtuar dhe të patrajtuar. Një kërkesë të fundit që e kemi si grup i LDK-së: Kryetar, e kemi një kërkesë që te çështjet që merren vendimet në Asamble, të na informoni me procedurat finale. Ta kemi një kopje të marrëveshjes me "Stone Castle" për çështjen e stadiumit, një kopje të marrëveshjes me Fondacionin "Adrian Orllati", ta shohim se çka kemi votuar dhe si është nënshkruar marrëveshja, si dhe ta kemi së paku listën e atyre që kanë marrë në shfrytëzim pronat e komunës, për të cilat ne i kemi votuar. Ne jemi duke marrë vendim për dhënie në shfrytëzim, për leje dhe për ndërrim të pronës, në fund, vendimi duhet të na kompletohet me informata finale nga drejtoritë përkatëse. Ne si Asamble, duhet të jemi në dijeni se kush e ka marrë pronën që, në fakt, ne e kemi lejuar. Dy marrëveshjet gjithashtu që i kemi, për stadium dhe me Fondacionin Orllati, nuk e diskutoj se a janë të mira, pa diskutim që po, në kuptimin e zhvillimit të sportit dhe të bamirësisë. Mos më paragjykon, mos më gjykon kinse jam duke hetuar, nuk jam i asaj natyre, por thjesht e kërkoj informatën që ta kemi secili prej asambleistëve.

**Kryetari:** Është praktike që pas miratimit të rendit të ditës, të vazhdojmë. Tani është pika ku mund të bisedojmë. Te Ilir Pallqa: Kanali i kullimit Fortesë-Shtavicë-Rahovec, besoj që është bërë mediale dhe ka pasur situata të cilat e sqarojnë gjendjen. Nëse ka diçka, janë organet profesionale që t'i trajtojnë këto tema. Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka sqarime të detajuara, nëse e vlerëson të përgjigjet. Sa i përket drejtorit të DKA-së, kjo çështje gjithashtu nuk është temë e kuvendit dhe nuk ka nevojë të merakoset askush, ligji është i barabartë për të gjithë. Duhet ta presim epilogun e procesit. Organet tona shtetërore besoj që kanë gatishmëri të japin përgjigje përfundimtare. Sa i përket QKMF-së, unë personalisht kam vërejtje në plot aspekte, sikurse kam vlerësimë unë dhe qytetarët për shumë arritje dhe shërbime. Besoj që QKMF-ja arrin të ofrojë shumë shërbime, që ia kanë lakmi edhe qendrat e komunave të tjera. Megjithatë, ata kanë një statut dhe punojnë në bazë të tij. I uroj se cilit subjekt politik, që të forcohen me kuadro më të mira, sa më shumë njerëz që merren aktivisht me politikë në kuptimin pozitiv të fjalës dhe me mendime të ndryshme, është më mirë për Rahovecin dhe për shtetin. Unë jam i thuar i aktivizmit! Dikush e do Ahmet Zogun, dikush Enver Hoxhën, dikush Sali Berishën, Edi Ramën, Hashim Thaçin, dikush Kadri Veselin, Ramush Haradinajn, dikush Albin Kurtin etj... Jemi në rregull me këtë temë. Shumë njerëz të cilët i kam të afërm, ia pëlqejnë Ilir Pallqës postimet dhe unë normalisht që nuk i ndëshkoj ata, pse mendojnë ndryshe. Nuk ka më këso parti, mund të jetë veç një dhe fatkeqësisht është më e madhja në Kosovë. Partia më e madh politike e këqyr a bën dikush foto me mua, sepse dikujt i

pengojnë. Mua nuk më pengon, nuk e kam asnjë kompleks të shkoj edhe në Hoçë të Madhe, bile më mirë unë sesa dikush tjetër. Burimi e ka paraqitur një çështje shumë interesante. Tani kemi kontratë për pleh kimik me një operator. Participimi 20% nuk i shkon operatorit, por i shkon komunës, pra, janë të hyra komunale. Kur i kam fituar zgjedhjet, si zotim publik e kam pasur 80% me 20%, që do të jetë raporti i subvencionimit. Ky 20% është i përcaktuar me kritere dhe nuk është mirë që subvencionimi të jetë total "gratis". Kjo është veç një etapë që jemi duke hyrë në inpute. Nuk është vetëm plehu kimik, por është edhe preparati "Cikadia", kundër insekteve në hardhi të rrushit. Nuk është kontratë shumë e madhe, por, besoj që të gjithë vreshtarët mund t'i trajtojnë vreshtat e tyre. Te plehu kimik, operatori e zgjedh barnatoren dhe jo komuna. Besoj që shpejt sivjet do të kemi kontratë për serra, do të provojmë të subvencionojmë në këtë mënyrë qumështin, bletarët dhe të gjitha fushëveprimtaritë e bujqësisë. Të merremi vesh, subvencionimi 20% do t'u takojë të hyrave komunale dhe jo operatorit. Sa u përket vendimeve, posaçërisht vendimet e kuvendit, të gjitha janë publike. Por, mund ta krijojmë një standard që nuk ka qenë asnëherë, duke e informuar Kuvendin për ecurinë ose dinamikën e zbatimit të kontratave, vendimeve dhe marrëveshjeve. Situata te qentë endacakë: është një situatë për të cilën edhe unë jam i pakënaqur. Në shkallë vendi është problematike. Në Komunën e Rahovecit, veterinarët janë duke i kryer disa punë, por, përsëri ka qenë endacakë. Është prioritet emergjent te ne. E kemi situatën sfiduese, sepse ligji për mbrojtjen e kafshëve është shumë i ashpër, duhet mos të kemi dilema që eventualisht mund të ndodhë ndonjë keqtrajtim i qenve endacakë. Më kujtohet kur e kam bërë një vendim që ndalon kacafytjen e qenve, Adelina Ismaili dhe disa shoqata britanike e kanë bërë shpërndarjen dhe lajmi ka arritur mbi 3000 shpërndaje. Duhet t'i marrim të gjitha masat që qenë endacakë mos të ketë hiç, ose sa më pak. Faleminderit Shqipe, për vlerësimet për kryetarin. Vlerësime ka gjithandej, siç ka edhe kritika dhe komente.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit, i nderuari kryesues! I nderuari kryetar, zv. kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë dhe të gjithë të pranishëm! Kryetar, së bashku me drejtorin e DKRS-së, ju kemi përcjellë, keni qenë aktivë duke e përkrahur klubin e hendbollit. Një vërejtje e kam këtu, a duhet që një klub të jetë pretendent për titull, që ju të merreni me atë klub? Apo duhet të merreni me të gjitha sportet që zhvillohen në komunë? Nëse ju kujtohet, kur është riformuar klub, kemi kërkuar subvencione dhe nuk jemi marrë parasysh fare. Në atë botë, unë isha kryetari i KH "Rahoveci". Në ato subvencione që i keni ndarë për ne, kemi bërë ankesë dhe ankesa është zhdukur, nëse ju kujtohet, kemi pasur takim në zyrën tuaj. Ankesa kurrë nuk është trajtuar edhe pse ka qenë e protokolluar. Atë ditë, një grup njerëzish, që në atë kohë ndoshta kanë qenë aktorë kryesorë që është zhdukur ajo ankesë, dalin në foto dhe krenohen me po të njëjtin klub. Është shumë në rregull dhe i takon kryetarit të komunës ta përkrahë klubin. Me të vërtetë është fotografi e bukur edhe në Pejë edhe si është vepruar. Në sportet e tjera a keni qenë ndonjëherë, së paku ta dini se ku janë. Klubet janë duke u shuar, jo vetëm në Rahovec, por edhe në rrëthinë. Ne kemi pasur shumë klube të mira në futboll, Ratkoci, Fortesa, Xérxa, Krusha. Nëse dëshirojmë ta mbajmë rininë të fortë, historikisht është sporti që i mban ata. Në atë kohë kur kemi kërkuar subvencionim më të madh në hendboll, keni qenë të koncentruar në basketboll. Subvencionimi në basket ka qenë bukur i majmë. Në momentin që ra basketi, më nuk përmendet nga komuna. Ju lutem, a keni ndonjë plan të mirëfilltë për inkudrimin e klubeve të ndryshme në sporte, si dhe të mos shikohet të subvencionohet një klub i cili momentalisht është në një fazë popullariteti dhe të dalim nëpër rrjete sociale që ne do t'ju përkrahim edhe më tepër, sepse ju po tregoni punë. Përkrahja e komunës duhet të jetë në nivel strategjik, ku është interes i madh i të rinjve dhe jo ku është momentalisht një klub, i cili arrin sukses me individë dhe subjekte private. E dyta, ju lutem që ta merrni në konsideratë sheshin në qendër, është me vite kaos në komunikacion. Nuk është marre ta pranon që është bërë gabim me atë formë të sheshit, të shikohet ndonjë dizajnim tjetër dhe të krijohet më shumë hapësirë për qytetarët dhe për mërgimtarët.

**Kryetari:** E para, fati e ka dashur që të jemi në demokraci dhe nuk kam frikë të shkoj as në Pejë, as në Rahovec, as kudo dhe nuk e pyes askënd. Klubi i hendbollit sivjet është përkrahur më shumë, sepse në kuadër të strategjisë që ne e përfaqësojmë, klubet që kanë sukses, traditë dhe perspektivë, ne i përkrahim. E kemi përkrahur fuqimisht klubin e hendbollit dhe jemi të kënaqur që tashmë ata janë kampionë. Jemi duke menduar ta gjejmë një modalitet edhe të

përkrahjes shtesë. Të njëjtit ekip, sipas rregullores, nuk kemi të drejtë t'i japim dy herë, por ne do të gjemë forma për t'i ndihmuar përsëri. Nga viti në vit, ne e kemi rritur përkrahjen për subvacione, sivjetë është rritur 17%, vitin e kaluar 23%. Komunat përreth nuk u japin hiç klubeve pare, sepse nuk janë OJQ, por shoqëri aksionare. Unë ndihem shumë mirë, sepse përkrahjen për klubet e kemi dyfishuar. Nuk mund t'i japim mbështetje apriori kërkujt. E kemi bërë një dallim me KF "Rahoveci", sepse është një klub me traditë gati 100-vjeçare. Nuk i mbështhes klubet që aktivizohen kur hapet thirrja për subvacione. Klubit nga Ratkoci nuk i kam dhënë, sepse kanë tentuar të aktivizohen në momentin kur është hapur thirrja. Faleminderit shumë, nuk ka subvacione! Nuk është fajtore Komuna, nëse klubet shuhën dhe në anën tjetër komuna ia dyfishon mbështetjen. Mos i kërkon kryetarit të Komunës diçka që nuk ka kurrfarë obligimi ligjor dhe nuk mund t'i kërkosh illogari pse ngrihet dhe pse shuhet një klub. Je duke folur me standarde të paraluftës, Bejtullah. OJQ-ve nuk ua zgjidhim problemin, i ndihmojmë ato. Ankesa është zhdukur, të lutem dërgoje në prokurori, afér është gjykata. Nëse i di kush janë, dërgoje në prokurori. Mos fol diçka që nuk e meriton ky Kuvend i Komunës. Bëhet fjalë para 4-5 vjetësh, thua që janë zhdukur dokumentet?! Prokurorinë e ke afér. Është mirë t'i lini makinacionet dhe mos harro që ke qenë kandidat për kryetar komune. Mos e lidh storien e suksesit me një gjë tjetër. Nëse dëshiron ta them të vërtetën, ankesën nuk e keni bërë me kohë hiç. E di saktë, ka qenë e pasafatshme! Te klubi i basketballit – "KB Rahoveci", është e vërtetë që e ka pasur një mbështetje më të madhe, por është shformuar ai klub dhe te ky klub i ri nuk e ka dorëzuar dokumentacionin, që kam shumë vërejtje për këtë. Tani bëhet fjalë për një klub të ri "Grapeland", të cilin gjithashtu e kemi mbështetur dhe atë jo pak. E kam përgëzuar atë djalin, Indrit Krasniqin, për një lloj motivacioni shumë të madh. Do të kenë sukses ata dhe krahas sukseseve dhe sinjalëve për sukseset, ne do t'u rrisim mbështetjen. Jemi komuna që prinë me numrin e aktivitetave për rini, meqë e përmende shumë rrininë. Kuptohet, bashkëpunojmë me SHL Kosova, me organizatat e tjera joqeveritare dhe falë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Programi "Komuna për të rinjtë" është një program që e ka fituar po ashtu KB Grapeland, në vlerë 14-15.000€. Ne kemi ndikuar në implementuesit aty, fondi është i qeverisë japoneze. Sa i përket qendrës, janë duke punuar dhe brenda javës, dy apo tri ditë, është planifikuar të shtrohet asfalti. Pas përfundimit dhe shenjimit, ulemi dhe flasim, i kam thënë edhe Merisës. Nuk e kam dizajnuar unë, të merremi vesh, e kanë dizajnuar inxhinierët dhe arkitektët e kësaj komune, si dhe gjithashtu ka pasur dëgjime publike në të cilat ti nuk ke qenë fare. Nuk e kam përtur të them që vonesat kanë ndodhur shkaku i KEDS-it. Për këtë u kam këruar falje qytetarëve të Rahovëcit. Tani, pothuajse është në finalizim. Nëse nuk funksionon, e hapim si temë dhe e shohim a mund ta bëjmë ndonjë zgjidhje tjetër. Unë jam i vetmi kryetar që flas hapur, kur edhe nëse bëhet diçka mirë, unë përsëri kam vërejte, e ju nuk jeni duke ditur të bëni as vërejtje. Për të qenë modest, po më vjen keq që shumë herë jam para shumëkujt. Nuk parashihet vetëm një herë në muaj të flisni, sado që mund të keni argumente të tjera. Dritoro Agolli e ka lënë një fjalë: "Ne shqiptarët, edhe mbledhjet e kuvendit i thirrim në orën dhjetë dhe ia fillojmë në dhjetë e gjysmë". E çuditshme është shprehia e vonesave të asambleistëve, sepse ekzekutivi i pret anëtarët e Kuvendit deri në 10:30, vetëm te ne ndodh. Nuk është në rregull kjo, prandaj unë them që jam para jush me kilometra. Me respekt për të gjithë, por kjo nuk është praktikë e mirë për të gjitha grupet e Kuvendit. Do ta shqyrtoj edhe mundësinë me drejtorin e Financave që t'i prekim në gjep asambleistët.

**Bejtullah Deliu:** Kryetar, besoj që u keqkuptuam, ose e marr si përgjigje politike. Thashë, mirë që ke marrë pjesë në Pejë, është për lëvdatë. Ju u përgjigjët: "Unë shkoj ku të dua". Në rregull, ajo ishte lëvdatë, mirëpo forma e mbështetjes dhe si ngarendet për një klub që është i suksesshëm. E mora shembull basketin, sepse është përkrahur në mënyrë enorme. Për një kohë të shkurtër shuhet dhe askush nuk jep përgjegjësi. Kur Komuna subvencionon, gjithashtu duhet të kërkojë raport. Nuk ishte qëllimi që pse po subvencionohet një klub, shpresoj të subvencionohen shumë më tepër. Një strategji në sport në tërësi, nuk e parashev subvencionimin vetëm kur ata janë në piedestal, por duhet t'i ngremë nga themeli. E marrim një shembull: në basket dhe në hendball, sa persona i kemi të komunës tonë që luajnë në këto klube? Qëllimi është këtu, t'i subvencionojmë gjeneratat e reja dhe shkollat sportive. Kritika ime nuk është për subvencionim, por, për formën e subvencionimit.

**Kryetari:** Formën e subvencionimit e përcakton programi dhe aplikacionet e tyre. Shumën e subvencionimit e përcaktojmë ne duke u bazuar në mundësitë buxhetore. Ndërsa, mos harro, unë nuk e financoj asnjëherë dështimin. Nxitjen dhe suksesin e financoj sa të mundem. Kjo është strategji që nuk e luan “Topi i Alamanit”, sepse në të gjithë botën është kështu. Në superligë i kam financuar më shumë klubet, sepse shpenzimet rriten. Klubi i hendballit është shumë mirë që është shpallur kampion. E kam pritur që do të dalin shumë prej jush aty për t'i pritur kampionët, por shumë pak kanë qenë ata që i kanë pritur dhe për këtë nuk besoj që jam fajtor. Kur i kam fituar zgjedhjet ju kam premtuar që subvencionimi për klubet sportive do të rritet shumë, për rini dhe kulturë. Do t'i rris subvencionet për bursa për studentë, mbështetjen për fermerë. Të gjitha këto prentime i kam mbajtur. E kemi rritur përkrahjen edhe për shoqëritë kulturo-artistike, për Ansamblin e Krushës, për OJQ-në e trashëgimisë dhe të traditës – HardhFestin. Në 2017-tën subvencionimi për HardhFestin ka qenë 8.500€ dhe sot po e ndihmojmë me 50.000€. Unë operoj me rritje.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të Kuvendit Komunal, qytetarë të komunës së Rahovecit. Kryetari e ka pasur një takim me udhëheqësit e KRU “Gjakova”, kërkoj informata shtesë sa i përket furnizimit me ujë të lagjeve të fshatit Hoçë e Vogël dhe Brestoc. Një rekomandim: Në takimet e radhës që do t'i ketë me ta, të flasë rreth riparimeve të gypeve dhe kthimi i rrugës të kthehet në gjendjen e mëparshme. Për drejtorin e Shërbimeve Publike: keni filluar me zgjerim të trotuarit në fshatin Brestoc, a keni planifikuar edhe për pjesën në Hoçë të Vogël? Për ndriçimin publik, keni premtuar që në qershori do të rikthehet dhe do të bëhet mbulueshmëria. Shkoi qershori, po vjen korriku dhe realisht nuk ka ndonjë hap konkret. Nga Drejtoria e Bujqësisë nuk kemi informacione shtesë përrugët fushore. Si anëtar i Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kërkoj nga ekzekutivi që të na përgjigjet rreth konkursit të fundit në QKMF. Zyrtare e të hyrave në QKMF është pranuar një familjare e zyrtarit që punon në atë institucion dhe është konflikt interesit. Një kërkësë të qytetarëve të fshatit Drenoc, konkretisht lagjes Berisha: Kanalizimi në atë lagje derdhet në rrugën kryesore, nuk ka gropë septike dhe kundërmon erë e keqe. Te drejtori i Shërbimeve Publike, pastrimi i rrugës kryesore Rahovec – Krushë e Madhe nuk është kryer siç duhet, ka vazhduar 1 km dhe më tepër jo.

**Merisa Sharku:** Përvshëndetje për të gjithë! Kërkesa ime e përhershme mbetet mbështetja e grave, sidomos subvencionimi dhe përkrahja e tyre në biznese *start up*. Subvencionimi i bizneseve dhe i artizanateve ka ndodhur këtë vit, e mira e kësaj është që ka filluar. Sot, dua të ndaj një ide - kërkësë konkrete. E pashë një shembull në një komunë të Republikës së Kosovës, nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, te zhvillimi strategjik apo te mbështetja e grave në biznese start up, kanë bërë thirrje për ndarjen e makinave qepëse automatike. Forma e aplikimit ishte e thjeshtë, kërkësë për certifikatën e biznesit ekzistues, apo pas përfitimit të regjistrohen bizneset e tyre. Kjo gjë ndikon në stimulimin për regjistrimin e bizneseve të reja. Ju bëj thirrje që t'i subvenciononi bizneset *start up*.

**Sinan Kryeziu:** Faleminderit, kryesues! Përvshëndetje për të gjithë! Meqë Ilirin e kam ish-bashkëpartiak dhe dost, e patat të nevojshme ta marr një replikë ndaj tij. E përgëzoj që është zgjedhur asambleisti më i mirë në Kuvend Komunal. Iliri foli për tri pika. Foli për kanalin e ujit në Fortesë; në këtë pikë përmendi përmbaruesin privat se pse punëmarrësi nuk e dërgon komunën në përmbarues dhe gjithashtu foli për krimin, për dy çështje penale dhe kontest civil, meqë jam edhe jurist, e dini të gjithë. Kompania punëkryesi, nëse ka pretenduar që i ka borxh komuna, ajo ka të drejtë ligjore të bëjë propozim për përmbarim, në këtë rast komunës. Komuna ka të drejtën e “dynjasë” të bëjë “prapësim” në përmbarim, nëse pretendon që iu ka bërë ky propozim në mënyrë të kundërligjshme (kontest civil). Nëse flasim për çështje penale, Iliri tha që këtu është duke u zhvilluar krimi në përmasa të mëdha. Besoj që dallimi prej çështjes civile dhe penale, te e para ka vonesa, te çështjet penale bëhet kallëzim penal, merret një aktvendim për fillimin e hetimeve, nëse është dyshimi i bazuar mirë, ngrihet një aktakuzë dhe bëhet një arrestim ende pa u bërë dënim i plotfuqishëm. Iliri foli edhe për drejtorin e QKMF-së, në këtë rasti u.d., Elbunit Kryeziu, i cili sipas tij bën anime aty. Unë i them Ilirit që drejtori i ka detyrat dhe përgjegjësitë e kufizuara, sepse është u.d. Ia përkujtoj Ilirit që në çdo kat të QKMF-së janë kutitë e ankesave. Ankesat bëhen edhe në mënyrë anonime dhe vijnë direkt te Drejtoria e Shëndetësisë, në Komunë, te Saranda Salltek. Besoj që brenda mundësive aty janë shërbimet shumë të mira. Iliri, po ashtu, foli edhe për drejtorin

e Arsimit, Avni Morina, të cilët i tha i pandehur. Fjala i pandehur ndoshta tingëllon keq, por asgjë nuk ka të keqe. Në drejtësi e kemi: prezumimi i pafajësisë – gjersa nuk vërtetohet fajësia e një të pandehuri, ai është i pafajshëm. Për koincidencë, këtu i kam disa statistika të nxjerra. Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, te dikasteri i Arsimit, në 2019, ka premtuar të fillojnë me çerdhe, deri në 2024. Premtimet e qeverisë Kurti - ishte që çdo vit t'i ndërtojë rreth 40 çerdhe dhe për 4 vite i bie 160 çerdhe. Statistikat thonë që në tërë territorin e Republikës së Kosovës, i ka ndërtuar 4 çerdhe. Krahasimi me Komunën e Rahovecit, që e kemi një buxhet simbolik, në këtë rast, Drejtoria e Arsimit ka ndërtuar tri çerdhe brenda vitiit 2023, me vlerë totale 919.889€. Çerdhet janë ndërtuar dhe në kontratë e ka që Ministria e Arsimit ta përfundojë inventarin. Në fshatin Xërxe, participojnë për tepih, sepse janë lëshuar në funksion, i kam dy vajzat e mia që vijojnë edukimin paraprak. Avni Morina, në kuadër të kryetarit, e ka bërë një punë të madhe, si dhe në proces e sipër e kanë ndërtimin e shkollës në Xërxe, i përgëzoj!

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit, kryesues! Përvendosje për të gjithë! Sa i përket asaj që kemi shkuar atje me kryetarin, nuk kam ardhur për ju krytar, por, për vete. Një gjë e tillë është shumë e mirë edhe nëse seanca do të vazhdonte, unë do të shkoja atje. Është vend i shenjtë shtëpia e bacës Avdi. U ndieva keq që nuk keni qenë edhe ju. Përgëzime për Ditën e Çlirimit dhe shpalljen Qytetar Nderi të ish-kryeministrat, Pandeli Majko. E kam pasur një vërejtje, që në atë mbledhje nuk i kam parë familjarët e ish-kryetarëve të komunës. E kam një pyetje për kryetarin: më ka rënë në sy, në hyrje të Zyrës së Kryetarit, janë fotografitë e ish-kryetarëve. Nëse ka bazë ligjore që aty të jetë edhe fotografia e Xhevdet Durakut, një kohë ka qenë u.d. i kryetarit të Komunës. Kam shumë kërkesa në Krushë, e di që është punuar shumë në Krushë. Do të provojmë që kërkesat për vitin e ardhshëm t'i paraqesim në dëgjimin publik në Krushë të Madhe. Drejtor i Kulturës, atë fushë që ka mbetur keq, me mundësi, finalizoje.

**Kryetari:** E konfirmoi edhe Sefa. As unë për Sefën nuk kam shkuar, as ky për mua. Sefa më tha që “ a shkojmë bashkë?” dhe shkuam. E dyta, për fotografitë, kjo ka qenë ide e imja. Aty janë fotografitë e kryetarëve, e që ne mund t'i lëmë edhe të nënkyetarëve, pa asnje problem. Zyrtarisht, Xhevdeti ka qenë u.d., bile as u.d. jo, ka qenë nënkyetar dhe kur të mungon kryetari, rolin e tij e ka nënkyetari. Nuk e di a është në rregull ligjërisht, por do ta shqyrtojmë. Sa u përket ftesave, ish-kryeministri Avdullah Hoti më tha që do të vija për Pandeli Majkon, por nuk ka qenë i ftuar. Vërejtje me vend, i thashë. E në fakt, kryetari i degës së LDK-së, duhet t'u bëjë ftesë atyre. Ne e kemi bërë një rikonceptim të formës dhe të metodës që t'i ftojmë të tjerët. Kryetari, së pari, nuk i dërgon ftesa kërkujt. Kësaj radhe, ka mundur të shpërndahet nga Burimi, Defrimi, Hasani, apo prej Sefës. Herën tjetër, Komuna, është e vërtetë që duhet t'i ftojë njerëzit dhe është vërejtje shumë me vend. Te investimet: në Krushë, nuk besoj që jemi keq, jemi në pritje të një materiali që quhet tartan, edhe përfundon fusha sportive, është çështje ditësh. Merisë, jemi duke biseduar me Drejtorinë e Ekonomisë. Bizneset artizanale që janë për gra, jemi duke e shqyrtau mundësinë për ndihmë me aq sa kemi mundësi. E kemi si prioritet.

**Burim Krasniqi:** Kur jemi duke diskutuar në Asamble Komunale, besoj që secili prej asambleistëve ka të drejtë ta kérkojë një informatë. Një gjë nuk më pëlqen, forma e përgjigjes me “haz”. Pak më qetë, sepse sidon që ta thuash e ka të njëtin kuptim. Me pas përgjigje të shkruar, nuk e di si ia bën, a mund të bërtasësh në shkrim. Kérkoj mirëkuptimin e asaj që funksionohet ashtu siç duhet. Sa i përket çështjes së subvencionimit, askush nuk besoj që ka dilemë rreth organizimit të Festës së Vjeljes së Rrushit. E kam kérkuar informatën dhe besoj që kur të vije momenti i informatës, mund të diskutojmë. Çështja e sporteve është shumë më komplekse sesa një subvencionim. Jemi zotuar bashkë që mos të prishet fusha e futbollit, ende pa e ndërtuar fushën në kompleksin sportiv te Maja e Shkodranit. Unë e di që sot nuk ka aktivitet klub i futbollit, por janë mbi 100 fëmijë të shkollës së futbollit. Bejtullahu, e tha, fëmijët janë e ardhmja e secilit klub sportiv. Fusha është prishur para dy javësh, është prishur keq. Nuk është hequr bari, as humusi, as gypat e dranazhimit brenda, si dhe betoni është mbuluar që ligjërisht nuk lejohet. Karriget e plastikës, të gjitha janë të mbuluara. Me ligjin për mbrojtjen e ambientit është e ndaluar të ndodhë kjo. Menjëherë pas mbulimit të fushës, makineria është tërhequr dhe nuk ka asnje lëvizje poshtë te sheshi qendror. Nëse ka pasur plan të aktivitetit të vazhdimit të punimeve, pse është dashur ta mbuloni para se të finalizohet çështja e fushës te Maja e Shkodranit? Kemi diskutuar bashkë, kur je

zotuar që nuk do të prishet stadiumi deri sa të rregullohet fusha te Maja e Shkodranit ose te Epopeja e UÇK-së. Në fakt, ka ndodhur e kundërta. Klubet nuk funksionojnë edhe në mungesë të infrastrukturës. Në qeverinë Mustafa, kanë qenë të parapara dhe të buxhetuara, rregullimi i fushës në Ratkoc dhe në Krushë të Madhe, qeveria Haradinaj i ka hequr. Në qoftë se është e pavërtetë, e shikojmë buxhetin. Nuk është sporti veç subvencionimi. Janë kushtet infrastrukturore, ndërtimi i shkollave sportive, ruajtja e kontinuitetit sportiv dhe subvencioni e ndihmon, ndoshta edhe komunikimi i vazhdueshëm me klube sportive dhe biznese, që gradualisht të bëhet zhvendosja prej OJQ-ve në ShA. Megjithatë, fusha e futbollit nuk është dashur të prishet, sepse e ka dëmtuar shkollën e futbollit në Rahovec. E fundit, drejtoreshë, Sinani nuk është këtu, por i tregoni Sinanit që u.d., i ka detyrat e njëjta me ato të drejtorit. E dyta, nuk e di a je në dijeni që ka rënë prej provimit për specializim në mjekësi familjare. Mos e merrni në qafë djalin, lirojeni për ta dhënë provimin e specializimit, më pas rikthejeni, sepse po ia merrni tërë kohën dhe nuk ka arritur ta japë provimin.

**Kryetari:** Nuk më ka rënë hise të jem asnëherë anëtar i LDK-së, sepse karakteristika e tyre është qetësia. Natyra më ka rritur pak më të ashpër. Nuk i marr gjërat me "haz" dhe sa për dijeninë tuaj, në situatat më të vështira, unë menaxhoj më mirë. Sa i përket stadiumit, flet Albnori. Punimet në kompleks janë duke vazhduar dhe sezoni i ardhshëm do t'i gjejë duke zhvilluar ndeshje në kompleksin sportiv, nëse me rregulla lejohet. Unë jam ihtar i afateve dhe i disiplinës, por nën tokë askush nuk po na tregon që ka gurë të mëdhenj (kërrsh), ose herën e parë kemi të drejtë të bëjmë minim dhe të dytën jo, etj etj... Ky kompleks e ka lodhur edhe operatorin (Euro-ing) duke i thyer gurët e paparashikueshëm. Ne jemi të vetëdijshëm që ka fëmijë që kanë ushtruar në stadium dhe nesër mundësish shko dhe thuaji "punë të mbarë" Famisit, do të rifillohet puna aty, sepse paraprakisht ka pasur që të rregullohet edhe disa niveli aty në shesh. I kemi disa memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunimi lidhur me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunën së Rahovecit, 19 prill 2019. Në atë kohë, kryeministër ka qenë z. Ramush Haradinaj, kryetar i Kuvendit, z. Kadri Veseli dhe president, z. Hashim Thaqi. Për ato terrene sportive-stadiume, shpeshherë e kam tepruar duke folur këtu. Memorandumi me Kujtim Gashin është nënshkruar për stadiumin në Ratkoc, stadiumin në Rahovec dhe të jetë palestra sportive në Krushë të Madhe. Xhavit Uka, ish-deputeti i LDK-së, e ka ndihmuar Komunën e Rahovecit për ta futur edhe stadiumin në Krushë. Unë kam thënë dhe po e përsëris, qeveria që ka ardhur, i ka hequr të gjitha, jo qeveria e PAN-it, por, janë hequr më vonë. Në qeverinë e PAN-it janë zhvilluar edhe procedura për hartimin e projektit për stadiumin në Rahovec, me vlerë 80.000 €. Përmes Xhavit Ukajt, kanë qenë të ndara 50.000 për stadiumin në Krushë, d.m.th kanë hyrë në buxhet dhe më pas janë larguar 4 projekte. Në mënyrë të njëanshme, është anuluar edhe memorandumi për sheshin qendror, në vlerë 5 milion €. Unë punët i marr me zemër dhe me shpirt, pse kam ton të lartë, nuk domethënë që jam i ngutshëm. Asnjëherë nuk bëj kualifikime i pari, në këtë kuvend, ju kam thënë "mos më ngucni, se jua kthej" dhe nuk është marre nëse këtë e kam dobësi. Jemi në mjedis publik. Këtu do të jem, sa herë të doni dhe si të doni!

**Ilir Pallqa:** Sipas nenit 47 të rregullores së Kuvendit, replika i jepet atij që ka folur paraprakisht pasi i përmendet emri. Nuk preferohet të flasim këtu me nene, ligje, apel e civil, sepse nuk po respektohen. Punimet janë duke u zhvilluar pa leje nga Komuna. Shqipja tha që është "sen" i mirë të jesh në AAK. Jo çdo herë "seni" i mirë është i drejtë. Janë dy "sene" të mira, të mirat publike dhe të mirat private dhe nuk e di për cilën të mirë e ka pasur Shqipja. Kryetari tha që je duke bërë fushatë. Defrimi e ka vizatu hajninë që është bërë dhe kryetari duhet të thotë, faleminderit shumë që e keni luajtur rolin e mbikëqyrësit. Në anën tjetër, ai thotë që jeni duke bërë fushatë. Tha që nuk e obligoj askënd të shpërndajë postime, por qejfi është duke iu bërë dhe kur i bëhet qejfi, bëhet favori. Çuditërisht, pasi fola unë, në anën tjetër, folën Sinani dhe Shqipja, respekt! Sinani foli për qeveri, këtu jemi për çështje lokale. Tani i kemi zgjedhjet afér, shpresojmë të kandidojnë për deputetë.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Vazhdojmë një pauzë njëorëshe të drekës...

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit, kryesues! Të kërkoj mirëkuptim, do të flas pak më shumë se zakonisht. Shkaku që në seancën e kaluar nuk e kemi pasur mundësinë dhe janë mbledhur disa çështje për diskutim. I nderuari kryetar, nënkyryetar, kolegë anëtarë të kuvendit, drejtore të drejtorive, zyrtarë, medie. Një kritikë që e tha kryetari për

"KosovaPressin", është e papranueshme përderisa ekziston kontrata, duhet të jenë më të përgjegjshëm në punën e xhirimit të seancave. Njëkohësisht, një kritikë tjetër prej seancës së kaluar që ka zgjatur rrëth 4 orë, xhirime të publikuara janë vetëm 28 minuta. Kryetari e tha që duhet t'i përcillet një vërejtje, të paktën të mos vazhdojë kjo qasje e njëjtë në të ardhmen. Fillimisht po replikoj te Shqipja, e përmendi kohën kur ka qenë në Vetëvendosje dhe që ka kaluar te më të mirët. Iliri tha diçka, për punën e Shqipes mund të jenë në relacion disa thënie të urta, unë po e them një: "Zogu, sado lart që fluturon, shqiponjë nuk bëhet". Shqipja edhe atëherë edhe tanë ka punuar për Aleancë. Një thënie tjetër: "Për ta njohur një person, pyeti kolegët e tij/saj për të". Çështja e fotografisë dhe pëlgjimet në facebook: E vërtetë që unë hezitoj të dal në foto me kryetarin e Komunës, gjithashtu nuk besoj që është diçka keq. Kryetari është i Aleancës dhe ne i kemi rrugët e ndara politikisht. Këtë problem nuk e kam me dikë tjetër edhe pse është i Aleancës. Me Besnik Hotin, kisha dalë pa problem në foto me të. Te pëlgjimet në facebook, nuk e ka vërejtur ndonjë anëtar të Aleancës që i pëlgjen postimet e mia. Sinani e përmendi që kutitë e ankesave janë në QKMF, por, anëtarja jonë e Kuvendit, Vlora Vuçitërna, në seancën e kaluar, e ka përmendur një problem që ankesat e qytetarëve që futen në këto kuti po asgjësohen. Kur vijnë ankesat te zyra e drejtoreshës për Shëndetësi, në momentin e hapjes, po i dalin vetëm lëvdatat. Ankesat po asgjësohen. Bejta e ka ngritur një çështje rrëth klubeve sportive, pajtohem me të plotësisht. E di që ndoshta nuk është shumë e drejtë që Komuna t'u kërkojë llogari OJQ-ve përfituese për veprimtaritë e tyre. Qoftë për klubet sportive, qoftë për HardhFestin. Te KB Rahoveci, të paktën, Komuna duhet të japë llogari ose arsyetim për mjetet që ka mbështetur këtë klub. Nëse nuk gaboj, në vitin e fundit, ekzekutivi e ka dërguar një anëtar të bordit aty dhe klub i është shuar. Te çështjet politike, kryetar, mund t'i diskutoh si të duash, me "haz" si Aleanca apo qetë si LDK-ja. Ne jemi këtu përballë, pavarësisht çfarëdo situate. Dua ta ngrë një çështje në lidhje me Drejtorinë e Inspeksionit dhe me Drejtorinë e Ekonomisë. Bëhet fjalë për rregulloren e orarit të punës për operatorët biznesorë në Komunën e Rahovecit. E dimë që është një rregullore që e përcakton orarin e punës, rregullorja është e vitit 2011. Kryetarit i kam thënë që është koha të ndryshohet mendësia e qeverisjes së Komunës. Bashkë me anëtarë të grupit tonë, gjatë muajve kemi vizituar biznese me këtë arsyetim, sepse kemi pasur kërkesa prej tyre që kjo rregullore të zbatohet dhe e diela të jetë ditë pushimi, specifikisht për depot e materialit ndërtimor. Me shumicën e bizneseve që kemi diskutuar, 98% prej tyre janë që të zbatohet kjo rregullore. Kërkoj që të mos e keqinterpretoni këtë te bizneset e tjera. E ftoj Drejtorinë e Inspeksionit që të fillojë ta bëjë një vërejtje te bizneset që, prej datës së caktuar, bizneset ta kenë të dielave ditë pushimi dhe të merren masa të mira ndaj atyre bizneseve që nuk i përbahen kësaj rregulloreje. Te Drejtoria e Ekonomisë, propozoj që të fillohet plotësim-ndryshimi i kësaj rregulloreje, sepse është e vitit 2011. Tani jemi në vitin 2024 dhe forma e të bërit biznes ka ndryshuar. Në seancat e kaluara e kam bërë një propozim për çështjen e kanalizimit në rrugën "Vëllezërit Frashëri". Pas insistimit tim, kryetari ka vendosur të shkojë ta zgjidh problemin dhe sigurisht kjo nuk ka mundur të realizohet pa mirëkuptimin e disa banorëve, që nëpër pronat e tyre është dashur të krijohet zgjidhja për kyçje në kanalizim për shumë shtëpi në rrugën "Vëllezërit Frashëri". Një propozim që e kam bërë ka qenë që ata qytetarë që tolerojnë dhe në interes të përgjithshëm të jalin diçka në pronën e tyre, në këtë rast ata duhet ta ndiejnë dorën e Komunës më shumë se ata qytetarë që nuk bëjnë asgjë. Marrëveshjen, kryetari që e ka bërë me ato familje aty, jo që nuk i është përbajtur, por, kryetari ka dalë edhe është lavdëruar që e ka zgjidhur çështjen e kanalizimit për më shumë se 50 shtëpi. Problemi është që shkaktimi i dëmit të krijuar në pronën e atij qytetari që ka kontribuuar për interes të përgjithshëm, minimalisht nuk është kthyer as në gjendjen e mëparshme, kjo është turp. Nuk mund të dalësh të lavdërohesh për një punë që e ke kryer në kurrit të dikujt tjetër dhe pa ia rikthyer pronën të paktën minimalisht, siç e ka pasur. Cilido qytetar që jep diçka për interes të përgjithshëm, ju ftoj që ta trajtoni atë me prioritet. Çështja tjetër: Nëse te kubëzimi i rrugëve po bëni politikë, siç është rasti duke filluar prej rrugës time dhe 3 rrugë të tjera që janë të pakubëzuara. Shtrimin e rrugëve e bëni në formë politike, të trija këto rrugë lidhen me familjarë që janë pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje. Unë e kam pranuar një përgjigje në kërkesën time, keni thënë që nuk ka mjete të mjaftueshme. Unë pajtohem plotësisht! Rrugës time nuk ka nevojë ta rregulloni, por të paktën ato dy rrugët e tjera. Kërkesa ka qenë për 65m kubëzim, ju nuk keni pasur fonde të mjaftueshme, përderisa kontrata për kubëzimin e rrugëve është aktive. Kryetar,

ka shumë biznese që nuk po iu ofroni infrastrukturë të duhur, përkundër investimit që ata po e bëjnë në Komunën e Rahovecit. Një rast e dini edhe ju, ka bërë kërkeshë të vazhdueshme, prej drejtorit nuk është që pres diçka, duke e njohur Përparimin dhe e di që nuk i intereson kjo përveç gjendjes së vet personale. Kërkoi prej teje kryetar, sepse besoj që dallon prej këtyre anëtarëve të ekzekutivit që i ke. Këto biznese duhet të trajtohen me prioritet. Të paktën t'ia ofroni infrastrukturën rrugore, që ushtrimi i biznesit të jetë më i lehtë. E kam vetëm edhe një kërkeshë shumë të shkurtër. Në një postim që e kam bërë në rrjetet sociale, një qytetar më ka shënuar dhe po e lexoj fjalë për fjalë: "Përvendetje Defrim! Po të shkruaj për një çështje shumë serioze dhe të lutem ta diskutoni në mbledhje, si dhe të kërkoni llogari nga kryetari. Përgjegjësi keni edhe ju për këtë gjendje të shkaktuar. Ruga e Rahovecit kurrë nuk kanë qenë më keq, kjo çka po bën kryetari është me bë hajgare me popull, a kanë ndjenja këta njerëz? As turp nuk kanë! A po na kthen shkaku i votave, sepse po vërehet ashiqare që me qëllim po bëhet dhe nuk ka arsy që m'i lënë rrugët në këtë gjendje. Të lutna që edhe ju t'i bëni presion, se m'u ka bë bajat edhe shtëpia ime prej pluhurit dhe prej gropave që s'po mbyllen kurrë. Shpresoj që ky mandat të jetë mandati i fundit!"

**Kryetari:** Kjo e fundit nuk ka të bëjë asgjë me realitetin! Turpin merre për vete. Ai qytetar që ka shkruar me këtë millef, le ta mban turpin për vete. Ne jemi duke punuar në qytet. E dyta, kubëzimi i rrugëve nuk ka të bëjë me politikë asgjë, ose ka mjete, ose s'ka. Ne mund të kemi kontrata aktive, por mund të kemi buxhetim të pamjaftueshëm. E treta, nuk e besoj që e mban fjalën ti, që the rrugën tani e shtroj vetë, sepse deri tani do ta kishe shtruar. Nëse kemi mundësi, ne do t'i shtrojmë. E katërt, një segment që mbulon me kanalizim të ujërave të zeza 50 familje, është i zgjidhur, me shumë vështirësi, por është i zgjidhur. Kjo nuk ka ndodhur për shkak që ke insistuar ti, këtu nuk ka lidhje kjo punë. Ka probleme serioze pronësore, ndërsa ne do të vazhdojmë me segmente të tjera. Është e drejtë legitime të bëni opozitë, por mos flisni me millef dhe inate. Mendësia politike po ndryshon çdo ditë, qeverisja jonë është e suksesshme dhe ju me këto logjika nuk do të vini kurrë në pushtet. Nëse i keni pasur 49% ndonjëherë, duhet ta shqyrtoni mundësinë e do të jeni partia e katërt apo e pestë. Ju duhet të merreni me problemet e brendshme në partinë tuaj dhe jo të merreni me problemet e partive të tjera. A del ti në fotografi me mua, apo jo? Nuk është që më ka marrë malli, por e tregova logjikën që ju keni përgjegjësi politike, ndërsa ne jo. Sa i përket asaj që të fusësh "mish dhie" brenda ekipit tim, kinse me Besnikun dal në foto e me kryetarin jo, këto "kopalla" është mirë t'i lini jashtë seancës. Moti jam në këto troje dhe më njeh. Përparimi është një nga drejtorët punëtorë më të mëdhenj. A ka probleme? Gjithsesi! Shërbimet Publike janë probleme, sepse më së shumti kërkesa ka kjo drejtori. Te plotësim-ndryshimi i rregullores së vitit 2011: Rregulloret tani bëhen përmes asociacionit të komunave dhe jepet orientimi edhe për komunat e tjera. Nuk do të thotë që nuk ka nevojë të bëhet plotësim-ndryshimi, në mënyrë që t'i ndihmojmë bizneset, por kjo nuk ka të bëjë me mendësinë, të vjetër ose të re. Te qytetarët që japid diçka për komunën: mos harro, kanalizimi pikërisht është për këta qytetarë dhe komuna nuk e ka të lehtë të investojë në prona private. Unë nuk shantazhohem, punoj për qytetarët dhe mos më ndërhyj përderisa jam duke folur. Ti i ke 200-300 vota dhe mirë që i ke dhe mundohesh kinse t'ua kthesht qytetarëve për shkak të votave. Ti e di që mbi 10.000.000€ ka investime në qytet, të cilat janë në vazhdim dhe këtë duhet t'ia thoni edhe atij qytetari që të paska shkruar, nëse je korrekt. -A ka gropë? -Po! -A po mbulohet gropat? -Po! -A janë duke punuar? -Po! Kjo është e vërteta. E diela: ti sa biznese i viziton brenda një muaji, 2 muajve dhe brenda 3 vjetëve, unë i vizitoj brenda ditës dhe jam në kontakt me ta. Logjika e politikës që përfaqësohet nga qeveria e Kosovës është logjikë e bllokimit të bizneseve, jo e lehtësimit. Politikë e varfërimit të qytetarëve dhe politikë e mosrespektimit të vlerave që përfaqëson ky vend. Kjo është logjika e qeverisë së Kosovës, që edhe ty të ka hyrë në kokë. Prandaj, në këtë vend nuk duhet të fitojnë kurrë këto politika, sepse në këtë vend është derdhur gjak. Shqetësimet e ngritura janë serioze sepse ne të gjithë jemi qytetarë të komunës së Rahovecit dhe qeverisja e tillë na dëmton tej mase. Te fotografitë: dil në fotografi me kë të dash dhe mua nuk më pengon hiç! Unë dal me kë dua dhe askush nuk guxon të më përzihet. Ndërsa ju jeni trima të guximshëm, çlirimtarë që e keni çliruar Kosovën për së dyti, për së treti e për së katërti, besa edhe komunën. Ju nuk guxoni të dilni në fotografi. Faletminderit që më lavdërove mua dhe e shave Përparimin! Asnjëherë nuk kemi thënë që jemi të përsosur, sepse nuk jemi të përsosur, por mos harro që asnjëherë nuk është e vërtetë nëse dikush thotë

që nuk ka arritje. Mos tē merremi me fyerje, sepse nē këtë hapësirë nuk është dashur tē ketë asnëherë fyerje dhe kualifikime siç je duke bërë ti. Nuk ke tē drejtë t'i thuash asnë asambleisti diçka tē asaj natyre që i the. Nuk ke tē drejtë ta ofendosh tjetrin se pse e ka ndërruar partinë, sepse ndoshta edhe ti nuk do t'i rezistosh dhe nesër mund tē kalosh nē tjetër parti. Nuk je i lidhur pér tërë jetën me VV-në, sepse dikur ti edhe familja juaj e keni votuar haptas PDK-në. Prandaj, kurrë mos fol keq pér një tjetër parti politike. Ju jeni pa shef grupi, jeni pa kryetar partie, nuk jeni askund. Nuk e dini as vetë ku jeni, nē tokë apo qiell. Demokracia nuk nënkupton që ta fyesh dikë. Ti i do bizneset e ne qenkemi kundër tyre. Kutitë e ankesave, janë kuti zyrtare nē QKMF, janë gjithashtu edhe nē komunë. Po tē isha prokuror, menjëherë tē kisha thirrur dhe tē tregosh se kush është ai që po i zhduk ato negative. Ti nē koncept je anarkist, kundër institucioneve. Shko thirre prokurorin dhe thuaji që ankesat janë zhdukur. Ne jemi shtet dhe nuk mund tē sillesh si anarkist nē këtë komunë. Aty ekziston një komision, i cili i hap kutitë dhe i shqyrton ankesat. Komisioni është i pavarur, nuk e bëjmë ne atë komision. Te OJQ-të: është një rregulllore 2017/4 që ka tē bëjë rreth subvencionimit të OJQ-ve dhe pér ato subvencione që i jep Komuna, OJQ-të përfituese obligohen tē raportojnë, përndryshe ZKA-ja tē "fshinë". Po ti nuk di çka është ZKA-ja dhe shumë gjëra tē tjera. Keni udhëhequr një vit e gjysmë me Kuvendin e Komunës dhe gjërat themelore nuk i dini. Një herë "KB Rahovecit" i ka dalë një dokumentacion jo nē rregull, nga ZKA-ja kemi marrë rekomandim tē veçantë. Kjo që po bëni nuk është opozitë. Është njëjtë si tē tentoni që gishtin e vogël tē këmbës së majtë, ta fusni nē vesh tē djathtë dhe vetëm Brus Lee është munduar ta bëjë këtë punë, ky nuk jeton më. "KB Rahoveci" dikur ka qenë nē superligë dhe ne e kemi ndihmuar shumë dhe jam krenar që e kam ndihmuar 43.000, vetëm le tē futet nē superligë dhe nëse kam mundësi do t'u jap 70.000€. Sa i përket bordit, ata e kanë ftuar Aliun, sepse iu është dukur më i përshtatshëm. Ali Morina ka marrë pjesë vetëm kur janë mbajtur ndonjëherë mbledhjet e bordit. Sa i përket që e diela tē jetë ditë pushimi, këtu deri diku ia ke qëlluar. Po them kështu, sepse njeriu që di, d.m.th. ia qëllon sepse di. Ndërsa, njeriu që nuk di, nuk e di alfabetin e institucioneve, duke folur shumë dhe pa lidhje, ndonjëherë edhe ia qëllon. Nuk mund tē thirresh nē emër tē tē gjitha bizneseve, sepse janë mbi 2000. Ne jemi vend rural, jemi punëtorë. A e dini se ka biznese që nuk e respektojnë as 17 Shkurtin, as 28 Nëntorin. Puntoret kanë ditë pushimi, dikush e ka tē dielën, dikush tē hënën, dikush tē premtën. Te depot e materialeve ndërtimore, ka qytetarë që pikërisht tē dielën shkojnë tē marrin materiale, pikërisht nē atë kohë që nuk kanë mundësi tē dalin inspektorët. Ekziston tanë një udhëzim i ri që inspektorët nuk duhet tē punojnë ditën e shtunë dhe tē dielën. Sa i përket fundit tē mandatit, unë funksionoj si kryetar deri nē orën 24, vetëm nëse më ndodh ndonjë gjë dhe nuk jam nē këtë botë, por edhe nëse më ndodh ndonjë gjë, zëvendësin e kam këtu. Ty vonë do tē tē vije radha, sepse nuk ecet me këto logjika. Ti vetëm që më mobilizon më shumë, që edhe ato votat që i ke pasur, nē fund njerëzit nuk do tē t'i japin. Grupi i Lëvizjes së Vetëvendosjes nē Rahovec, pushtetin e keni tē paarritshëm. Duke më kritikuar mua pa lidhje, ma rritni më shumë prestigjin dhe do ta zvogëloni veten, ndërsa unë nuk kam qejf që ju tē zvogëloheni, sepse kam dëshirë tē jeni parti serioze. Shumica e anëtarëve tē partisë suaj, tē gjithë janë duke ardhur tek unë. Kritikat tuaja vetëm që më kalitin më shumë, që nesër tē më kërkoni falje dhe tē thoni: duam tē vijmë nē partinë tuaj dhe unë t'ju them, jo, nuk ju pranoj.

**Defrim Kafexhiu:** Çdo fjalë që e them nē foltore, mbaj përgjegjësi para ligjit dhe para njerëzve. Lirisht mund ta thërrasësh prokurorinë nē atë që fola, qoftë pér kutinë e ankesave. Nëse ti i fsheh veprimet e njerëzve tē caktuar, që janë nē zinxhirin e këtij pushteti që ti po e udhëheq, është problemi yt. Në këtë cilësi që jam, me këto 200-300 vota që i kam, iu dal hakësh atyre. Ne mund tē kemi probleme partiake që ti thua. Ne edhe një nga një përballë do tē qëndrojmë, nuk e ndërrojmë këtë qasje. Fol pér demokraci dhe na mban ligjérata këtu, unë gjithashtu mund tē flas pér demokraci, si dhe pér 50% tē votave që i ka Lëvizja Vetëvendosje nē nivel nacional. A e dini pse? Partia juaj e ka bërë dëmin, që Lëvizja Vetëvendosje tē vije nē pushtet. Jo që na duan ne njerëzit, por që nuk ju duan ju. Unë nuk dal nē foltore pér tē shpifur. Të bësh cilësimë tē veprimeve tē familjes sime, kjo është e papranueshme dhe është shpifje. Të paktën prej një kryetari tē Komunës, absolutisht është e papranueshme. A di unë, apo jo? Tjetër kush e vlerëson! A vij unë nē pushtet apo jo? Nuk varet nē pushtet. Unë e di që ne tē treve këtu, nuk ke qejf tē na shohësh, sepse nuk tē shkojmë pér shtati. Ne e dimë shumë mirë se çka ke qejf ti. Nuk mund ta bëj sipas qejfit tënd, zhvillimin e politikës sime. Unë jam këtu

për interes të qytetarëve dhe i përfaqësoj ata. Në Vetëvendosje nuk ka anarki, foto bëjmë me çdokënd, është çështje e vullnetit tim. Te pëlqimet në rrjetet sociale, anarki keni ju. E keni instaluar anarkinë brendapartiake.

**Kryetari:** E para, ti po i prekë asambleistët. Unë nuk të preka në familje, por thashë kanë qenë votues të PDK-së dhe nuk është marre kjo gjë, shqyr që keni qenë dhe tanj keni rënë në fund të pusit, po flas në kuptimin figurativ. E dyta, anarkist jeni në koncept dhe në politika, se ti nuk e kpton fjalën anarki. Nuk e kam problem t'ju shoh ju, por, mos kujtoni që jeni duke bërë opozitë. Për opozitë frikësohem kur flet Rasimi, Burimi shpesh, ka qenë edhe më parë Salih Hoti, Qazim Qeska. Këto kritika të sotshme, nuk mërzitem, nuk kanë bazë dhe janë insinuata. Sa i përket asaj që keni probleme të brendshme, e thashë që me këto logjika, probleme do të vazhdoni të keni. Pajtohem plotësisht që gabimet kanë qenë të politikanëve të mëhershëm, që LVV-ja i ka marrë 50%. Kjo logjikë tutje nuk do të jetë, sepse do të mbeteni 2 ose 3. Ti nuk guxon të dalësh në foto me dikë, jo pse do të rrähë dikush, por e pranon telefonatën dhe të thotë që "kush të ka thënë të dalësh me atë kriminel", sepse fjalori është kështu aty. Përndryshe, politikat e Lëvizjes Vetëvendosje, jo njerëzit, është fatkeqësia më e madhe që në këtë Kosovë kanë dominuar – e vetmja fjalë që jam pajtuar me Kadri Veselin është kjo. Janë rrëth 3 muaj e gjysmë që jemi duke e pritur nënshkrimin e ministrit për VSM-në, nuk e ka nënshkruar ende. Është dokument i gatshëm dhe është gjithçka në rregull. Nesër mund të më akuzosh se pse nuk po e bën Hartën Zonale. Dy vjet kemi pritur për shpronësimin e *Veda Oil*? Pse duhet të presim dy vjet? Unë kritikoj me fakte dhe kur bisedoj me shokun tim, me ministrin, thotë: Po, do ta shkojmë! Sot jemi në qershor, ende nuk e ka nënshkruar. Mendoj që u konsumua kjo pikë mjaftueshëm. Sot do të udhëtoj në një vend. Seancën e kemi bërë me këtë datë, më 25, vetëm të tregoj ty dhe secilit që unë nuk i iki ballafaqimit currë! I vetëdijshëm që jemi me plotë sfida, por, punët përfundojmë vetëm kur të shkojmë në atë "dynja". Në momentin kur të arrijmë marrëveshje t'i vazhdojmë segmentet e tjera për kanalizimin aty dhe përrugë më pas, unë jam gati, e ndërpres punën në Brestoc, Ratkoc, Xërxe ose Krushë, sepse e konsideroj me rëndësi jetike atë.

### **3. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (janar – qershor 2024) të kryetarit të Komunës:**

**Kryetari:** Faleminderit shumë! Raporti 6-mujor pothuajse u diskutua, jo 6-mujor, por 60-mujor! Unë për gjithçka jam i gatshëm!

**Egrem Spahiu:** Kryetar, Opterusha, qe një javë nuk ka ujë të pijshëm. Ndërsa, ju, qe një orë po flisni me Defrimin me njëri-tjetrin. Gjakova aspak nuk është e interesuar t'i rregullojë sanimet e bëra. Drejtori është afër aty, ai për vete e ka rregulluar problemin, sepse me ujë furnizohet nga pusi i tij.

**Kryetari:** Kur nuk isha unë brenda sallës, dikush nga ju e parashtroi një pyetje se si kemi kaluar me KRU "Gjakova" - Lirigzoni. Një e di që ka filluar procedura e prokurimit nga KRU "Gjakova" për projektin e madh që vjen deri te zona ekonomike, përfshin Rahovecin, Zaqishtin, Opterushën dhe Hoçën e Madhe, projekti është në vlerë 1 milion €. Menaxhimi është shumë i dobët. Përgjegjës për moment për KRU "Gjakova" është Hysni Çanta.

**Egrem Spahiu:** Ai është duke thënë që mos më kontaktoni mua, sepse nuk jam më përgjegjës.

**Kryetari:** Atëherë, e paskan dërguar në komision disiplinor! Kur ta përfundoj unë raportin, do ta thërras kryeshefin, Hasan Krasniqi, që e ka bërë politika kryeshef. Do ta pyes se çka po ndodh me ujë të pijshëm këto momente dhe do t'ju tregoj. Në takimin me ta nuk është që kemi kaluar më së miri. Raporti 6-mujor i punës, e ka pjesën e ligjit se ku bazohet. Ne e kemi obligim ligjor për çdo 6 muaj, si dhe ta mbajë një takim publik me qytetarë, të cilin e kemi mbajtur. Mirë i ka ardhur shumëkujt që ka pasur njerëz, ndoshta dikush prej asambleistëve ka qenë, Merisa ka qenë. Raporti i ka zotimet për 4 vjet, prioritetet ndërrojnë nga viti në vit. Janë edhe raportimet e të gjitha zyrave të kryetarit: Zyra për Informim, Zyra Ligjore, Zyra e Auditimit të Brendshëm, Zyra e Prokurimit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Avokatura dhe të gjitha raportet për të gjitha drejtoritë komunale. Dokumenti është publik, bashkë me listën informuese për aktivitetet kryesore që e kanë karakterizuar komunën gjatë këtij gjashtëmujori. Ky raport është diskutuar drejtëpërdrejt me publikun dhe sot është në diskutim edhe në kuvendin e komunës. Sa i përket HardhFestit, nuk ka bleta. HardhFesti organizohet në patronatin e Komunës. Ka pasur ide të atyre nga OJQ-ja, që në të ardhmen të vetëfinacojnë festivalin. Nuk ka bleta për qytetarë.

**Burim Krasniqi:** Shumë pak kam për raportin gjashtëmujor dhe pak për HardhFestin, meqenëse unë kam qenë ai që e kam kërkuar këtë informatë rrëth organizimit të HardhFestit. Sa i përket raportit gjashtëmujor, te çështja e prioriteteve, ky bashkëpunimi me KEDS-in dhe KRU “Gjakova” nuk po dhetë. Është zotim për bashkëpunim, por nuk ka bashkëpunim. Nëse personalisht nuk mund ta gjesh formulën të flasësh me ta, dërgoje dikë tjetër. Te zotimet, ndoshta dikur do të bëhen, por, tani sa i përket legalizimit të parkingjeve dhe krijimit të parkingjeve të tjera, për momentin jemi keq. Te sfidat: unë i lexova disa sfida që janë kryesisht bashkëpunime dhe përkrahje nga qeveria, por, sfidë momentalisht është edhe gjendja financiare për Komunën e Rahovecit. Arsyetimi ka qenë i vazhdueshëm që ne do të punojmë, ne do t'i bëjmë, por kjo shfaq problem në drejtim të ecjes tutje. Te ankesat është diçka interesante, e kam lexuar, thonë që janë pranuar 160 ankesa dhe përgjigje zero. Besoj që është gabim teknik, ose diçka ka ndodhur. Te HardhFesti: informatën e kam kërkuar për një arsy, sepse e kam parë në medie çështjen e biletave. Ligjërisht ajo është festë e Komunës, që rregullohet me statutin e Komunës dhe organizohet në patronatin e kryetarit të Komunës. Nuk mund të ndodhë ndonjë gjë, pa aprovimin e menaxherit të projektit, i cili caktohet nga kryetari i Komunës. Jeni monitorues i çdo hapi që e bën HardhFesti. Ne, si Asamble, dëshirojmë që kryetari i Komunës të kujdeset që HardhFesti t'i ketë dy gjëra: të zhvillohet dhe t'u krijojë mundësi qytetarëve të Komunës së Rahovecit ta bëjnë promovimin e mirëfilltë të traditës, të trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore, sepse në pak komuna mund të vizitohet teqja, xhamia dhe kisha. Ajo që më ka interesuar është se pse Ministria e Bujqësisë e ka ndalë përkrahjen për HardhFestin? Thjesht, mua nuk më interesojnë veprimet e OJQ-së, por vetëm të ekzekutivit dhe kërkoj që kryetari i Komunës, përmes personave që i delegon, ta ketë vullnetin e plotë që HardhFesti ta ruajë qëllimin e përshkrimit që e ka në statutin e Komunës së Rahovecit.

**Kryetari:** Unë besoj shumë te drejtoret e mi. Ata janë bukur “tarzana” dhe veç unë e di se si i shpejtoj punët me ta. Jam shumë i irrituar me qasjen që e kanë edhe KRU-ja edhe KEDS-i. Është e vështirë të punohet me ta. Ujë ka më shumë, Komuna e Rahovecit mbi 700.000€ në kohën e Idrizit i ka paguar për ujë, e tani ujë ka më pak. Të gjitha këto probleme të menaxhimit të dobët, të papërgjegjshëm dhe tendencioz në relacion me Komunën. Për këto situata unë i kam thirrur dhe iu kam thënë të gjitha në sy. Po them që me qejf nuk takohem as me KEDS-in, as me KRU-në, por, mos të kisha reaguar, gypi te “Gëzim Hamza” si shembull, shihni tani sa shpejt po përparojnë punët. E njëjta gjë vlen edhe për qendër, përndryshe vonesat do të ishin ndoshta edhe gjashtë muaj. Te sfidat: sfidë është buxheti i pamjaftueshëm, si dhe vonesat që janë si pasojë e mungesës së buxhetit. Legalizimi i parkingjeve është një zotim, por zhvillimet aktuale që janë duke ndodhur në shesh, nuk është që kemi shumë mundësi. Nesër fillon rrënim i objektit të Podrimes së dikurshme dhe të pompës, i gjithë ai vend do të jetë për parking të përkohshëm për mërgimtarët dhe për qytetarët e tjerë, deri sa të përfundojnë punët e tjera. Te ankesat: mund të jetë edhe gabim teknik, por ne e kemi për detyrë t'u përgjigjemi të gjithave, 160 ose 1600 nëse janë. Këtu qëndrojmë mirë dhe vlerësohem nga organizatat që i monitorojnë komunitat. Festa e Vjeljes së Rrushit është ditë zyrtare e komunës e rregulluar edhe me statut. Te organizimi ia ka marrë dorën OJQ “HardhFest” dhe njëkohësisht jemi të interesuar të kemi zhvillime dhe dimensione të reja nga viti në vit. Ne e kemi irritur përkrahjen për organizatorët që operojnë, për herë të parë është 50.000€. Ministria e Bujqësisë, kësaj radhe i ka përkrahur verëtarët dhe i ka ndëshkuar vreshtarët. Unë jam ihtar që t'i përkrahim edhe ata, edhe këta. Ka një tendencë që mos të merret shumë me vreshtarë, por të merret me përpunues. Ndërsa, Festivali i Vjeljes së Rrushit, ka vite që nuk mbështetet nga Ministria e Bujqësisë. Imagjinoni, Ministria e Kulturës, e mbështet, e ky jo. Ministri, kur vjen në komunë, nuk vjen hiç në Komunë. Ne marrim grante, subvencione, marrim edhe kompensime për dëme, por atij nuk duhet t'i vije inati, sepse buxhetin e “babës” nuk e ka, por e ka të këtij populli. HardhFesti është shumë keq që nuk ka mbështetje nga Ministria e Bujqësisë dhe ju siguroj këtu që ai ministër nuk do ta marrë fjalën. Vitin e kaluar ia kemi dhënë në formë respekti, por sivjet nuk e merr fjalën, sepse të gjithë e mbështesin festivalin dhe e vetmja është Ministria e Bujqësisë që jo, as sivjet, as vitin e kaluar dhe as para dy vjetësh. Presidentja e shtetit vjen tek unë e në Komunë për vizitë, ndërsa ai zotëria nuk vjen. Nenad Rikallo ka ardhur për vizitë, sepse e ka ditur që është trevë bujqësore.

**Ilir Pallqa:** E përgëzoj kryetarin për takimin me qytetarë, ka qenë shumë pamje e mirë. Ne kemi qenë me Dafinën atje, të cilën po ashtu e përgëzoj që është zgjedhur asambleistja më e mirë. Kur është diçka e mirë, nuk është mirë t'i futni duart. I futët në basket, ra prej ligës. OJQ-në lëreni të ecën përderisa ka sukses. Te puna e raportit gjashtëmujor, a mund të bëhet një fushë e vogël sportive me bari sintetik 40 me 20, aty ku është parkingu, te palestra afër Xhelës? Është nevojë e madhe për grupmoshat e reja, shqyrtoje me Albionin se ai e di më mirë këtë punë, do të dilte shumë më mirë, gjelbër dhe bukur.

**Kryetari:** Ajo është pjesë e sheshit qendror! Për momentin kemi problem veç për stadium. Fusha sportive ka, salla të edukatës fizike, bile edhe fusha të tenisit. Ka fusha sportive në qytet dhe në fshatra. Nuk besoj që ka vend për këtë gjë, sepse është e paraparë për shesh. Sa u përket subvencioneve, kryetari i Pejës, klubit të hendbollit dhe të basketbollit nuk ia jep asnjë lek, sepse janë kthyer në shoqëri aksionare. Në këtë drejtim ka ngelur Rahoveci dhe është mirë të ndërrrohet ky drejtim. Suhareka i futi dy klube në superligë, Balia vetëm mirën johje jep, nuk jep pare. Si mos të futen ata në superligë, kur lojtari ynë paguhet 500€, i atyre mbi 4000€. Kështu që është mirë që klubet të kthehen në shoqëri aksionare dhe ne tani të shpërndajmë mirën johje. Sporti është shumë i shtrenjtë, nuk është më si përpara. Bejtë, nëse hendbolli kthehet në shoqëri aksionare, atëherë besoj që do të jetë kampion vazhdimisht.

**Lirigzon Kastrati:** Nëse e analizojmë këtë raport me atë të viteve paraprake, del se në këto raporte pasqyrohen vetëm dëshira të përsëritura dhe asnjë veprim konkret. Siç shihet, shumica e prioritetave janë të përsëritura nga viti në vit dëshirohet ky drejtim. Besoj që kryetari është i obliguar që të plotësojë këtë raport, duke treguar edhe periudhën se kur mund të përfundojnë këto prioritete dhe synime të përsëritura. Pastaj, në raport janë paraqitur edhe disa sfida, ndërsa si sfidë është paraqitur edhe mungesa e hapësirave publike, andaj në këtë drejtim dëshiroj ta pyes kryetarin se çfarë masa janë ndërmarrë për identifikimin e hapësirave publike? A ka hapësira publike të uzurpuara e që mund t'i shërbejnë komunës dhe çfarë qëllimi të investimeve ka Komuna në këto hapësira publike?

**Kryetari:** Synimet dhe prioritetet 4-vjeçare janë program qeverisës dhe ne mund të flasim në tetor të vitit të ardhshëm për këtë dhe nëse jemi të interesuar t'i ikim kësaj, është instituti GAP ai që mat zotimet e zbatuara dhe premtimet e çdo kryetari të secilës komunë të Republikës së Kosovës. Mund të them që deri në qershor të vitit të kaluar, ne i kemi 39 premtime të përbushura, nga 84. Te matja e re, synojmë të shkojmë 51-52 premtime të përbushura. Na mbesin mbi 20 gjysmë të përbushura, të pafilluara i kemi 2-3 sfida. Njëra nga këta të fundit është ligji për bujqësi, që këtë zonë e shpall më ndryshe, e që vazhdimisht jemi duke e kërkuar nga ministri që e përmenda më herët dhe nga kryeministri që nuk është duke u iniciuar. Kemi gjithashtu diçka që lidhet me çerdhet. Është e vërtetë që kam premtuar që çerdhe duhet të bëhen në Opterushë, Drenoc, Çifllak, por është bërë një raport analistik nga MASHT-i dhe UNICEF-i, që nuk lejohet ndërtimi i çerdheve aty. Nuk e kemi kalkuluar mirë, kemi menduar që jemi "të parët e fisit" dhe çfarë të themi ne është e vërtetë. Ka qenë fushatë dhe i kemi futur në program. Pak më vonë do ta shohim se ku jemi me shkallën e realizimit të synimeve dhe të zotimeve. Jemi komuna që realizojmë më së shumti premtimet, sepse edhe premtimet i kemi realiste. Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Meqë edhe pikë e katërt është konsumuar, vazhdojmë me pikën e pestë.

##### **5. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027:**

**Arim Limani:** Inderuari kryesues, nënkyetar, asambleistë. Në mes të majit të këtij viti, ka arritur qarkorja e parë buxhetore, ku janë përcaktuar edhe limitet apo tavanet buxhetore për buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2025, si dhe projekcionet 2026-2027. Buxheti në total është 20.982.000€. Këtë buxhet e përbëjnë: Granti i Administratës prej 9.168.00, nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, atëherë, ky grant ka rritje prej 681.000€. Granti i Arsimit është në shumën 7.330.000 dhe ka një rritje prej 191.689€. Granti i Shëndetësisë është 2.452.000 dhe kur e krahasojmë me vitin 2024 ka një zbritje prej 84.000€. Në bazë të këtyre mjeteve financiare, buxheti do të shpërndahet në kategori ekonomike në këto vlera: Pozicioni i pagave: 10.552.000, kur e krahasojmë me vitin 2024, kemi një rritje prej 125.949. Mallra dhe Shërbime: 2.761.000, që ka një rritje prej 294.000€. Komunalitë mbesin të njëjta. Subvencionet janë 1.1 milion, që kanë një rritje prej 120.000 dhe investimet kapitale janë 6.268.000€ dhe në raport me vitin 2024 është një rritje prej 617.726€. Ky është buxheti sipas qarkores së parë buxhetore. Në mes të korrikut vjen edhe qarkorja e dytë dhe përfundimisht caktohet buxheti preleminar.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, ne e kemi diskutuar KAB-in edhe në KPF. Është fakt që është një dokument që nuk varet prej Komunës, por prej Ministrisë së Financave. Kërkohet votë prej Asamblesë, por nuk e di as vetë pse? Për shkak që

tavanet buxhetore nuk përcaktohen prej neve. Meqenëse ka kohë dhe gjithashtu e kemi një dëgjim tjetër për qarkoren buxhetore, pastaj buxheti. E kam kërkesën e njëjtë, ta kemi një konsensus të plotë rrëth miratimit të buxhetit. Sfidat buxhetore ose obligimet kontraktuale është fakt që e pamundësojnë ndarjen e buxhetit në projekte specifike. Kërkoi që kur vjen buxheti, ta kemi një listë të zotimit të projekteve. Jo listë të kërkesave të lagjeve, fshatrave ose të OJQ-ve, por, prioritetet se çka do të bëjë Komuna e Rahovecit për vitin 2025. Forma e buxhetit se si është e shpërndarë, në përjashtim të disa projekteve, sheshi qendror, shkolla ... pjesa tjetër: zgjerimi i trotuareve, i kanalizimeve apo rrugët, janë projekte të paspecifikuara se cila lagje dhe cilë rrugë do të bëhet.

**Ilir Pallqa:** Zyra e Kuvendit Komunal, për investime kapitale nuk ka buxhet hiç, kryetarit, prej 180 i është bërë 280. Prandaj ai e ka qasjen kështu.

**Burim Krasniqi:** Te çështja e buxhetit, te departamenti i Shëndetësisë, që është zbritur buxheti. Të paktën ta dimë se çka do të bëjë qeveria, që është zvogëluar buxheti këtu.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit shumë, kryesues! Përvendetje për të gjithë të pranishmit në sallë! I përmendi Burimi tavanet buxhetore. Më përpala kemi pasur probleme rrëth këtyre kategorive, sepse auditori i jashtëm i vlerëson si keqklasifikime. Ishin rrëth subvencioneve dhe mallrave dhe shërbimeve, projektet i vendosnin në investime kapitale, pikërisht prej kësaj qeverie që jeni sot. Më intereson a ka ndonjë rregullore dhe si caktohen tavanet buxhetore? Para 2-3 viteve për subvencione kanë qenë 350.000€, tanë është bërë 850.000 dhe sivjet propozimi është për 1.1 milion €. Këto tavanet buxhetore, kush i cakton dhe a po bëhen sipas qejfit?

**Afrim Limani:** Është në rregull me kërkesën e Burimit, i cili e bëri një kërkesë për një listë të projekteve kapitale të definuara. Zotohem që do ta kesh edhe pse nuk e kam obligim. Shëndetësia, pse ka buxhet më të vogël, të them të drejtë nuk e di as vetë. Me siguri janë disa gabime teknike, sepse numri i punëtorëve në shëndetësi është 198, në qarkoren e parë janë 190, i bie 8 punëtorë më pak. Ilir, subvencione nuk ka Kuvendi, as projekte kapitale. Gjithashtu, Zyra e Kryetarit nuk ka projekte kapitale, por subvencionet po. Subvencione kanë: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Kuvendi e ka kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Mësuesi Rasim, faktikisht, përcaktimin e buxhetit në kategori ekonomike e bëjmë ne. Si i bëjmë? Në ligj të buxhetit shkruan saktë, së pari e ndajmë buxhetin për Shëndetësi, pastaj për Arsim. I rregullojmë këto dy buxhete specifike, pastaj merremi me buxhet të Administratës. Duhet të jemi në dijeni sa kemi paga, pastaj kategoria e subvencione dhe mallra dhe shërbime dhe pjesa tjetër për investime kapitale. Fokus kryesor i yni është që t'i rrisim investimet kapitale.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Me 16 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e pestë.

## **6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, P-02302-0, P-02299-0, ZK – Rahovec:**

**Erhan Morina:** Faleminderit, kryesues! I nderuari nënkyetar, kolegë drejtorë, anëtarë të Kuvendit, medie. Pas propozim-vendimit të kryetarit, të datës 29 shkurt 2024, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të dy parcelave, të cilat janë pronë e komunës, zk – Rahovec. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim ka qenë për panele solare. Pas miratimit nga Kuvendi Komunal dhe pas ligjshmërisë nga ministritë përkatëse, komisioni është mbledhur dhe i ka caktuar kriteret për zhvillimin e procedurave të ankandit publik. Dhënia në shfrytëzim ka qenë për 15 vjet, në përputhje me ligjet dhe afatet kohore. Komisioni tanë është mbledhur dhe ka bërë vlerësimin e ofertave, si dhe ka konstatuar që në këtë ankand ka fituar kompania "Rahoveci Solar – Energy" me seli në Prishtinë. Çmimi i ofertuar nga kjo kompani ka qenë çmimi minimal i përcaktuar nga Kuvendi Komunal, 2531.78€, konkretisht 01.5 cent për m<sup>2</sup>.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, the që rrjedha e ecurisë fillon pas ligjshmërisë dhe pas kontratës. Neni 4 thotë që pagesa fillon sipas nenit 3 të vendimit, nenit 3 thotë që prej 1.8.2024! A është gabim teknik, apo? Neni 4, thotë: Çmimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të lartcekura, do të jetë: 2539.78€ në muaj, realizimi i pagesës është cekur në nenin 3 dhe kjo nënkupton që prej 1 gushtit ai fillon të paguajë qira.

**Erhan Morina:** Në vendimin paraprak të datës 21 shkurt, është cekur që periudha e pagesës fillon pas 36 muajsh, d.m.th., kompania ka grejs-periudhë për 36 muaj. Këtu veç është bërë një lëshim, sepse realisht në nenin 3 ceket që periudha e pagesës fillon pas 36 muajsh.

**Mirsad Shala:** I nderuar, këtu te neni 4, e kam cekur që çmimi i dhënes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës do të jetë 2539€ në muaj dhe realizimi i pagesës është cekur në nenin 3 të vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak. Është marrë një vendim për dhënien në shfrytëzim me një vendim paraprak, pas këtij vendimi është marrë ky vendim i ri që i jepet kësaj kompanie, sepse pas dhënes së pëlqimit paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në Kuvend, duhet të merret edhe një vendim.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Mirsad Shala! Atëherë, në qoftë se nuk kemi diskutime të tjera, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është “për”... Kundër...? Abstenim?... Atëherë, me 16 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

## **7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01, Nr. 2918, i datës 26.10.2018, për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Bazuar në ligjet e Kosovës, para jush keni vendimin për shfuqizimin e vendimit me nr. 01/2918, i datës 26.10.2018, për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe. Me këtë vendim, shfuqizohet vendimi me nr.prot. 01 nr.2918 i datës 26.10.2018 për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe.

**Kryesuesi:** Atëherë, diskutimi është i hapur! Nëse nuk kemi asgjë, e vendosim në votim, kush është “për”... Kundër?... Me 13 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e shtatë.

## **8. Shqyrtimi i Informatës rreth gjendjes së mbeturinave në Komunën e Rahovecit;**

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Në mungesë të koordinatores, zonjës Bjondina Ramaj-Fazliu, të paktën më ka autorizuar të jap disa informata të përgjithshme rreth gjendjes së mbeturinave në Komunën e Rahovecit. Para jush e keni një raport nga dy kompanitë, njëra është publike, tjetra private. Këto kompani menaxhojnë mbeturinat në komunën tonë. Përveç të dhënavë për mbeturina, janë të përfshirë edhe larjet e rrugëve dhe pastrimet që i bëjnë gjatë sezonit veror dhe dimëror, si dhe për punën që i obligon kontrata. Komuna e Rahovecit dallon prej komunave të tjera, sepse në bashkëpunim me “Jaica”, jemi duke menaxhuar edhe me mbeturina të vëllimshme, i mbledhim dhe i dërgojmë në deponinë legale të mbeturinave.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, i kam dy çështje. Te e para, çështja e mbeturinave jo të ngurta (të amvisërisë), kompanitë private a janë të nënkontraktuara nga kompanitë publike, apo direkt prej komunës? E dyta, te mbeturinat e ngurta është pika kontrolluese, a ka vend aty, apo zhvendosen diku tjetër? Në momentin e zhvendosjes, a bëhen në prona publike që mbushen gropat, apo iu mundësohet personave privatë t'i mbushin parcelat e veta me material të ngurtë. Konsideroj që Komuna e Rahovecit ka shumë vend për zhvendosje të tillë, në Krushë të Madhe dhe Xërxë.

**Përparim Krasniqi:** I nderuar, sipas ligjit të prokurimit publik, çështja e mbeturinave i takon 100% Komunës. Komuna e shpallë procedurën dhe nuk i intereson a është privat, apo publik. Për shkak të një marrëveshjeje të vitit 2008, komuna jonë operon me dy kompani dhe prej asaj kohe kontrata vetëm është vazhduar. Sa i përket deonisë legale për mbeturina të ngurta, aktualisht aty janë 11 hektarë të komunës. Studimin e vizibilitetit e ka bërë Demos-i bashkë me komunën, aty është hapësirë e madhe. Vendimi i Kuvendit i ka obliguar t'i paguajnë mbeturinat e ngurta për 0.40 cent për metër kub dhe që mos t'i paguajnë kompanitë private, hedhin ku të gjejnë hapësira. Përndryshe, kompanitë private janë të obliguara të drejtohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe të Inspektoratit me një kërkesë. Ne ia japim një pëlqim dhe nëse e kanë mbushur atë pjesë, rrafshohet. Përndryshe, në komunën tonë kemi pastruar shumë deponi ilegale dhe fatkeqësisht ka ende nëpër prona private.

**Burim Krasniqi:** Ndoshta rregullorja komunale i obligon, por, mund të bëhet edhe plotësim-ndryshimi. Po filloj prej një parimi, duke e pasur nevojën e mbushjes së vendeve që janë dëmtuar dikur fatkeqësisht, konsideroj që për një periudhë të caktuar ta heqim atë, ose komuna të paguaj diçka për atë pjesë, që vetëm e vetëm ata që rrënojnë shtëpi dhe që nuk është i dëmshëm për ambientin duhet ta dërgojnë në një vend të caktuar dhe nëse është nevoja komuna duhet t'i

kompensojë diçka dhe vetëm e vetëm që në mënyrë graduale të fillojë sanimi i pronave publike, i degraduar gjatë periudhës së pasluftës.

**Përparim Krasniqi:** Kanë tentuar që t'i bëjnë deponitë legale, në Krushë, në Xërxe dhe në Ratkoc, mirëpo për shkak të hapësirës së ngushtë dhe që toka mund të ndotet për shkak të mbeturinave, sepse paraprakisht është bërë një fizibilitet dhe studim. E thashë më herët, që paraprakisht duhet të pajisen me leje nga drejtoria.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Nëse nuk kemi pyetje, vazhdojmë me pikën tjetër. Pika e nëntë, rreth HardhFestit, besoj që është konsumuar me ato informacione që i dha kryetari, vazhdojmë me pikën e fundit.

#### **10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe sheshevë në Komunën e Rahovecit:**

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit, kryesues! Duke u bazuar në ligjin për sistem të adresave, para jush keni vendimin për plotësimin e listës rezervë për emërtime të rrugëve, të sheshevë dhe të parqeve në Komunën e Rahovecit. Me vendim të Kuvendit, është formuar komisioni prej pesë anëtarëve, tre prej tyre kanë qenë prej Kuvendit dhe dy prej ekzekutivit. Komisioni gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 12 takime me qytetarë. Të gjitha kërkesat e arsyeshme i kemi procesuar dhe i kemi dërguar në Agjencionin e Sistemit të Adresave. E kemi marrë një pëlqim prej tyre që këta emra mund të kalojnë tutje. Kërkoj prej jush që të votohen këta emra që fillimisht do të futen në listën rezervë. Pas aprovimit, komisioni mblidhet përsëri dhe në bazë të kërkesave që kanë ardhur, shpërndahen nëpër segmente të caktuar.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, bashkë me drejtorin e Gjeodezisë, në Komunën e Rahovecit, ka disa rrugë që kanë pasur ndryshime të emrave me kalimin e kohës. Kur futem në gjeoportal, ka shumë rrugë që s'kanë emra, pse nuk janë adresat dhe emrat e rrugës në total? Në qytet, në gjeoportal, ka plot rrugë pa emra. A ekziston mundësia që këtë listë që e keni ta dërgoni në Agjencionin Kadastral dhe të futen emrat në gjeoportal?

**Feriz Thaqi:** Këtu po e shoh në listë që janë edhe emrat e parqeve. A kalojnë edhe emrat e parqeve në listë rezervë?

**Albnor Mullabazi:** Te emrat që nuk dalin, zakonisht përditësohet në sistem të adresave dhe e kemi zyrtarin i cili merret me këto përditësime të të dhënave. Çdo rrugë që i ka më shumë se 100m dhe në atë rrugë të pozicionuara janë më shumë se 10 shtëpi, atëherë ka të drejtë që rruga ta ketë një emër. Do ta shikojmë se pse nuk janë duke dalë emrat në gjeoportal. Te propozimet e parqeve, kalojnë direkt nëpër parqet e kërkua.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Atëherë, në qoftë se nuk kemi diskutime të tjera, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 15 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e fundit e rendit të ditës. Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe durimin, shihemi në seancat e radhës!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni

PROCES VERBAL